

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 10 dhe nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), duke vepruar sipas Njoftimit për ndarjen e planifikuar të ndihmës të dorëzuar nga Ministria e Financave nr. 15-10684/1 të datës 10.12.2025, në seancën e mbajtur më datë 11.12.2025, miratoi këtë:

AKTVENDIM

Propozim-Ligji për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për obligimet sipas Marrëveshjes së huasë për financimin e Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe për financimin shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup (SHA ESM – Shkup), paraqet **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, e cila si **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ndahet nga Ministria e Financave dhe ndarja e së cilës është **e lejuar** sipas nenit 8 paragrafi (2) pika b) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, sepse bëhet fjalë për ndihmë të dedikuar për avancimin e realizimit të projekteve me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Padia për iniciimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm "Ligji"), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm "KMK") është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të ndihmës shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore, i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit, është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit, të dorëzojë në KMK njoftim për çdo plan për ndarjen e ndihmës së re ose ndryshimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, pavarësisht nëse e njëjta ndahet si ndihmë individuale apo si skemë ndihme.

Në lidhje me Propozim-Ligjin për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për obligimet sipas Marrëveshjes së huasë për financimin e Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe për financimin shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup (në tekstin e mëtejshëm "Propozim Ligji"), Ministria e Financave me shkresën nr. 15-10684/1 të datës 10.12.2025 (Nr. ynë 10-179 i datës 10.12.2025) dorëzoi Njoftim për garancinë e cila i jepet Shoqërisë Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup (në tekstin e mëtejshëm "SH.A. ESM Shkup") nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Ministrisë së Financave në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për dorëzimin e njoftimit për ndarjen e ndihmës

shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/11).

Në shtojcë të Njoftimit me shkresë nr. 15-10684/1 të datës 10.12.2025 nga ana e Ministrisë së Financave u dorëzuan Propozim-Ligji për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për obligimet sipas Marrëveshjes së huasë për financimin e Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe për financimin shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, Marrëveshja e huasë e cila duhet të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe SH.A. Elektranat e Maqedonisë së Veriut (SH.A. ESM – Shkup), Shkup, për 60.000.000 euro Projekti për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe Projekti për rivitalizimin e hidrocentraleve – financim shtesë, dhe Marrëveshja e garancisë e cila duhet të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Financave.

KMK vlerësoi se Njoftimi i dorëzuar nga ana e Ministrisë së Financave është i rregullt dhe përmban të gjitha të dhënat e parapara në nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit, respektivisht se njoftimi i tillë sipas formës dhe përmbajtjes është në përputhje me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për dorëzimin e njoftimit për ndarjen e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese (në tekstin e mëtejshëm "Rregullorja").

KMK gjatë shqyrtimit të njoftimit vërtetoi gjendjen faktike vijuese:

- **Dhënës i ndihmës shtetërore është:** Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Financave.
- **Shfrytëzues i ndihmës shtetërore është:** Shoqëria Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup.
- **Baza juridike për ndarjen e ndihmës shtetërore** paraqet aktin juridik në bazë të të cilit ndahet ndihma – Propozim-Ligji për Garancinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për obligimet sipas Marrëveshjes së huasë për financimin e Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe për financimin shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup.

Për të vërtetuar nëse një masë e ndërmarrë nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore paraqet ndihmë shtetërore, vlerësohet në mënyrë kumulative përmbushja e katër kriterëve vijuese:

- Masa e tillë të përfshijë shpenzim potencial ose të realizuar të mjeteve shtetërore;
- Të jetë selektive;
- Të paraqesë avantazh ekonomik për pranuesin; dhe
- Të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë.

Sipas KMK-së, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, ndan ndihmë shtetërore në formë të garancisë individuale për SHA ESM – Shkup. KMK vërtetoi se Propozim-Ligji paraqet ndihmë shtetërore për shkak të faktit se:

- Përfshin shpenzim potencial të mjeteve shtetërore sepse në nenin 1 të Propozim-Ligjit është paraparë që Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e obligimeve dhe përmbushjen e dispozitave nga Marrëveshja e huasë për financimin e Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe për financimin shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe SH.A. ESM Shkup, në shumë prej 60.000.000 euro, nëse SHA ESM Shkup nuk i përmbush dhe nuk i servison obligimet nga Marrëveshja e huasë.
- Selektiviteti shihet në faktin e përcaktimit të vetëm një operatori ekonomik – SHA ESM Shkup, i cili merr garancinë;
- Paraqet avantazh për pranuesin sepse me ndihmën e tillë të ndarë shtetërore i mundësohet përparësi ekonomike në treg në krahasim me konkurrentët tjerë të cilët nuk do të marrin lloj të tillë të ndihmës; dhe
- Ndihma e tillë ka ose mund të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë sepse cenohet ose mund të cenohet konkurrenca përmes mundësimin të përparësisë ekonomike për SHA ESM – Shkup.

Në këtë rast, gjatë shqyrtimit të lejueshmërisë së ndarjes së ndihmës shtetërore, e në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) të Ligjit, KMK zbaton Shënimin e Komisionit Evropian për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Marrëveshjes së Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore në formë të garancive (Commission Notice on the application of Article 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees – EUR-Lex – 52008XC0620 (02) – në tekstin e mëtejshëm Shënimi).

Vlerësimi i ndihmës shtetërore nga ana e KMK-së bazohet në pikën 3.2. nga Shënimi (garancitë individuale). Në këtë pikë, përmes përmbushjes së kushteve të caktuara, është theksuar se si përcaktohet nëse ekziston ose nuk ekziston ndihmë shtetërore në garancinë e lëshuar. Përmbushja e kushteve të theksuara në pikën 3.2. nga Shënimi nuk nënkupton ndihmë shtetërore për garancinë e dhënë shtetërore, nëse: a) ndërmarrja nuk është në vështirësi financiare; b) vëllimi i garancisë mund të matet saktë në momentin kur jepet (garancia duhet të jetë e lidhur me transaksion financiar të caktuar, për shumë maksimale fikse dhe e kufizuar në kohë); c) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huasë së mbetur ose mjeteve tjera financiare (siç do të ulet borxhi edhe garancia të mos mbulojë më shumë se 80% të huasë ose obligimit financiar), me ç'rast ekziston përjashtim për ndërmarrjet që kryejnë shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik; dhe d) garancia e dhënë duhet të kompensohet me premium përkatës.

Duke pasur parasysh se në këtë rast nuk janë përmbushur dy kushtet e fundit, KMK vlerëson se në këtë rast bëhet fjalë për ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore.

Lidhur me Projektin për centralin fotovoltaik Bitola 3, në Njoftim është theksuar se me të njëjtin pritjet të arrihet rritje e fuqisë së instaluar nga burimet e rinovueshme të energjisë prej minimum 134 MWdc, si dhe rritje e prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 175 GWh në vit. Me implementimin e projektit do të rritet pjesëmarrja e burimeve të rinovueshme të energjisë në vend me çka do të kontribuohet për përmbushjen e përcaktimeve strategjike dhe obligimeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare për pjesëmarrjen e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe atë:

- kapaciteti i instaluar i centralit fotovoltaik Bitola 3 – 134 MWdc, me ç'rast prodhimi mesatar vjetor i energjisë elektrike do të arrijë rreth 175 GWh;

- do të rregullohen rreth 200 ha tokë në rrethin e minierës në REK Bitola, për të cilën SHA ESM ka obligim për rekultivim.

Më tej është theksuar se përmes rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë me këtë projekt, do të kompensoheshin emetimet vjetore të CO₂ nëse kjo energji do të prodhohej nga termocentralet dhe atë:

- 130.000t – për kapacitetin e instaluar prej 134 MWdc dhe
- prodhim mesatar vjetor i energjisë elektrike nga centrali prej 175 GWh.

Implementimi i Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 do të kontribuojë drejt gjallërimit ekonomik të vendit, avancimit të tranzicionit energjetik, nxitjes së ciklit të fortë të rritjes ekonomike, financave publike stabile, rritjes së standardit të jetesës, jetë më të mirë dhe më cilësore për secilin. Gjithashtu do të mundësohet nxitja e efikasitetit energjetik, sigurimi i sigurisë energjetike dhe stabilitetit përmes rritjes së investimeve në sektorin energjetik. Duke pasur parasysh faktin se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka nivel të lartë të ndotjes së ajrit, veçanërisht në rajonin e Bitolës, për shkak të djegies së druve, naftës dhe lëndëve djegëse fosile në rrethin e REK Bitola, me realizimin e këtij projekti do të mundësohet mbrojtja e mjedisit jetësor dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, ulja e ndotjes së ajrit dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike, përmes shfrytëzimit të diellit si burim i rinovueshëm i energjisë. Njëkohësisht do të sigurohet siguri dhe pavarësi më e madhe energjetike, si dhe stabilitet përmes rritjes së investimeve në sektorin energjetik dhe rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme të energjisë në konsumin final. Për realizimin e projektit parashihet hua nga KfW në shumë deri në 50 milionë euro, të siguruara me garanci shtetërore.

Lidhur me Projektin për rivitalizimin e hidrocentraleve, në Njoftim është theksuar se parashihet hua nga KfW në shumë prej 10 milionë euro e dedikuar për financim shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve dhe me të cilin do të kontribuohet që të shfrytëzohet tërësisht potenciali ujor i hidrocentraleve ekzistuese, të kryhet modernizimi i pajisjeve të vjetruara me të reja, rritja e fuqisë së agregateve, të arrihet prodhim sa më i madh, të ulen shpenzimet rrjedhëse për mirëmbajtje dhe si qëllim përfundimtar të rritet siguria dhe stabiliteti i të gjithë sistemit elektroenergjetik në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rivitalizimi i impianteve do të rezultojë me rritjen e kapacitetit prodhues për 13,5 MW shtesë (3,5 MW në HE Vërben me zëvendësimin e pajisjeve të turbinave dhe 10 MW në HE Tikvesh me zëvendësimin e transformatorëve) dhe prodhim shtesë të energjisë elektrike prej rreth 47,5 GWh/vit. Gjithashtu rivitalizimi përfshin masa të synuara drejt rritjes ose mirëmbajtjes së sigurisë operative të hidrocentraleve ekzistuese. Jetëgjatësia e hidrocentraleve do të prolongohet dhe me këtë sigurohet balancimi i tyre i sigurt dhe sigurimi i energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të shtetit. Plotësisht, pajisjet e reja do të garantojnë efikasitet më të mirë dhe rritje të prodhimit të energjisë elektrike, pa ndikuar në regjimin e ujit. Projekti është gjithashtu i harmonizuar me zotimin për tranzicion në energji të pastër, që do të thotë ulje e importit të energjisë, zhvillim i burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE), forcim i sigurisë energjetike rajonale, sigurim i rritjes më të madhe ekonomike dhe përballje me sfidat ekzistuese me ndotjen.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, me realizimin e këtyre projekteve, jepet kontribut i madh drejt arritjes së prioritetëve strategjike dhe qëllimeve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktuara me Vendimin për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024-2028 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 177 e datës 26.08.2024). Aktivitetet e lidhura me këtë projekt janë në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të parashikuara me dokumentet strategjike: Programi i punës i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024-2028, Instrumenti për reforma dhe rritje i Ballkanit Perëndimor,

Agjenda Reformuese e Maqedonisë së Veriut 2024-2027 dhe Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2024-2028.

Në nenin 1 të Propozim-Ligjit për Garancinë, Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e obligimeve dhe përmbushjen e dispozitave nga Marrëveshja e huasë për financimin e Projektit për Centralin Fotovoltaik Bitola 3 dhe për financimin shtesë të Projektit për rivitalizimin e hidrocentraleve që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim – KfW dhe Shoqërisë Aksionare për prodhimin e energjisë elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi shtetërore, Shkup, në shumë deri në 60.000.000 euro, nëse SH.A. ESM – Shkup, nuk i përmbush dhe nuk i servison obligimet nga Marrëveshja e huasë. Nëse ndodh që SH.A. ESM Shkup të mos i përmbushë dhe servison obligimet nga Marrëveshja e huasë, shpenzimet në lidhje me të njëjtën do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Afati për kthimin e huasë është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë deri në tre vjet. Huaja do të kthehet në këste gjashtëmujore të cilat do të arrijnë për pagesë më 15 maj dhe 15 nëntor.

Nga e lartpërmendura KMK konkludoi se Propozim-Ligji paraqet ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 5 paragrafi (1) të Ligjit për shkak të faktit se ndihma e tillë e ndarë nënkupton shpenzim të shtetit dhe e njëjta cenon ose mund të cenojë konkurrencën përmes mundësisimit të përparësisë ekonomike për një ndërmarrje të caktuar e cila nuk do të ishte e mundur pa ndihmën shtetërore të ndarë ose përmes favorizimit të prodhimit të mallrave të caktuara ose dhënies së shërbimeve të caktuara. Ndihma e tillë shtetërore e ndarë nga ana e Ministrisë së Financave është e lejuar në kuptim të nenit 8 paragrafi (2) pika b) të Ligjit, sepse bëhet fjalë për ndihmë të dedikuar për avancimin e realizimit të projekteve me interes të rëndësishëm ekonomik për Republikën e Maqedonisë.

Për shkak të të lartpërmendurës, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vendosi si në dispozitivin e aktvendimit.

Në përputhje me nenin 26 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit, përveç në rastin kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, ndarja e së cilës nuk është e lejuar.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të dorëzohet padi për inicimin e kontestit administrativ në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ